



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.97/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada – Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në hapsirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 4,100.00 (katërmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e marrjes-pranimi të këtij vendimi, **nën kërcënim të përmbaramit**.

A r s y e t i m

Paneli, me datën 06.06.2017, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017, në Rrugën “Skenderbeu” në Komunën e Kamenicës, është bërë shkelje e kodit të mirësjelljes për subjektet politike dhe kandidatët ngase janë vendosur postera nëpër drunjtë, në parkun publik, të kandidatit për deputet të Republikës së Kosovës, Rexhep Kadriu nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA etj. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se koalicioni PDK-AAK-NISMA etj me vendosjen e posterit të kandidatit të saj në vend publik, konkretisht në drunjtë ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4 par.1 pika (b), të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013 dhe nenit 3 par.4 të Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2014. Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës i ka prezantuar PZAP-it, një fotografi nga vendi ku është vendosur posteri që është objekt lëndor. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të aprovohet dhe ndërmarren veprimet ligjor ndaj shkelësit të kodit të mirësjelljes për subjektet politike dhe kandidatëve.

Koalicioni PDK-AAK-NISMA, në përgjigje në ankesë të datës 07.06.2017, thekson se me të marrë urdhërin për masat e përmirësimit nga PZAP-i, lidhur me rastin Anr.97/2017 të datës 05.06.2017, i kanë ndërmarrë të gjitha veprimet për ta përmirësuar shkeljen e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, duke i larguar posterët e kandidatit në fjalë, nga vendet ku ishin të vendosura. Mëtej në përgjigje në ankesë theksohet se strukturat e AAK-së, nuk i kanë

vendos në Rrugën “Skënderbeu” në Kamenicë, nëpër drunjë të qytetit posteret, mirëpo kjo mund të jetë bërë nga qytetar apo individ të paidentifikuar. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, te cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimt, ka konstatuar se dy postert e kandidatit për deputet Rexhep Kadriu, nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, janë vendosur nëpër drunj, në park publik, e cila çështje nuk është mohuar as nga përgjigja në ankesë e Koalicionit PDK-AAK-NISMA.

Më këtë rast, PZAP-i, vlerëson se koalicioni i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike”*

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vndimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterat e kandidatit për deputet nga ky koalicion janë vendosur në hapsirë publike, gjegjësisht nëpër drunjë në parkun publik, po ashtu e njëjta shkelje nga ky koalicion është përsëritur disa herë në këto zgjedhje.

Me rastin e vendosjes paneli mori parasysh edhe pretendimet e koalicionit të theksuar me lart, që theksohet se posterat në fjalë nuk janë vendosur nga strukturat e këtij koalicioni, mirëpo janë vendosur nga persona të pa identifikuar. Këto pretendime paneli i vlerëson si të paqendrueshme dhe pa asnjë bazë ligjore sepse nenin 32 par.5 të LZP-së, përcakton se subjekti politik, mban përgjegjësi për shkeljen e kodit të mirësjelljes, të kryer nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre.

Paneli poashtu vlerësoi me rastin e vendosjes, lidhur me gjobën e shqiptuar si në dispozitivë të këtij vendimi, përpjekjet e koalicionit PDK-AAK-NISMA, i cili ka ndërmarrë masa përmirësuese për evitimin e shkeljes së kodit të mirësjelljes, duke i larguar posterët nga vendi që ishin të vendosur, me çka konstatohet nga fotografit e ofruar si provë që gjenden ne shkresat e lëndës, të cilat masa përmirësuese kanë ndikuar në vendim-marrje, me rastin e shqiptimit të gjobës.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.97/2017 më datën 07.06.2017.

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevc



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.